



## 2 Bashkim familjar tek një shtetas zviceran

**Qëllimi:** Për personat të cilët janë të kurorëzuar me shtetas zviceran (me kapacitet martesor) dhe dëshirojnë të jetojnë tek bashkëshorti ose bashkëshortja në Zvicër.

**Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.**

### DOKUMENTET E NEVOJSHME

<input type="checkbox"/> 3 formularë "Visa D" të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte.	<input type="checkbox"/> Certifikata origjinale e martesës, e lëshuar nga shteti ku është lidhur kurora.
<input type="checkbox"/> Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit (pasaporta) si dhe 2 kopje.	<input type="checkbox"/> Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër.
<input type="checkbox"/> 2 kopje të pasaportës të bashkëshortit/-es në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Vërtetim origjinal nga gjykata si dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme se personi nuk është nën hetime.
<input type="checkbox"/> 1 Kopje të certifikatës për kapacitet martesor lëshuar nga zyra e çështjeve civile në Zvicër. (certificat de capacité matrimoniale) (Ehefähigkeitszeugnis)	

### INFORMATA TË RENDËSISHME:

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- \* Të gjitha vendimet të cilat janë në gjuhë lokale duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Personi i cili jeton në Zvicër duhet të informohet drejtpërdrejt me zyrën kompetente të migracionit për ecurinë e procedurës.
- Formularët si dhe informatat mund të merren falas nga Ambasada e Zvicrës.
- Ambasada nuk mund të përgjigjet në pyetjet në lidhje me statusin e dosjes në Zvicër.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Terminet caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet).
- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet në ambasadë përmes e-mail, postes, ose fax-it.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.



### Si caktohet termini ?

- **Caktimi i terminimit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: [pristina.visa@eda.admin.ch](mailto:pristina.visa@eda.admin.ch). Ju lutëm të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të personit që dëshiron të bëjë kërkesë për bashkim familjar.**
- **Marrja e vendimit :** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente në Zvicër. Bashkëshorti/ja në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lusim që të vini me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të **hënës deri të premtën prej orës 8:00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.**

### Vula apostile

Të gjitha certifikatat/dokumentet duhet të pajisen me vulë apostile nga gjykata e shkallës së parë (nëse nuk janë certifikata internacionale).

### Pagesa

#### Falas

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrate.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).
- Tarifat mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

### Kujdes nga agjencitë

Personat që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë rrethojave të zeza nuk kanë asnjë lidhje me ambasadën. Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me ndonjë agjenci dhe stafi i ambasadës zvicerane nuk ka asnjë kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane ka të drejt:

- të kërkojë dokumente shtesë.
- ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
- t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
- ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.